

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikagard®-700 S

IMPREGNIM I PADEPËRTUESHËM NGA UJI ME BAZË SILOKSANI



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikagard®-700 S është impregnim prej 1 përbërësi, i padepërtueshëm nga uji për nënshtresa absorbuese me bazë çimentoje. Depërton mirë tek poret e hapura të nënshtresës, duke ofruar padepërtueshmëri të qëndrueshme ndaj ujit, ndërsa lejon ende difuzionin e avujve të ujit tek të dyja drejtimet. Sikagard®-700 S plotëson kërkesat e EN 1504-2 për impregnim hidrofob (thellësi depërtimi kategoria I)

PËRDORIMET

Sikagard®-700 S përdoret si trajtim mbrojtës pa ngjyrë kundër depërtimit të ujit për materialet absorbuese të ekspozuara si betoni, suvatimet me bazë çimentoje, pllaka betoni, çimento me fibra, mure me tulla (argjil dhe rërë gëlqereje, të paqelqëzuara), gur natyror, etj. Sikagard®-700 S mund të përdoret gjithashtu si prajmer hidrofob nën veshjet me bazë tretësi ose emulsioneve mbrojtëse.

Sikagard®-700 S përdoret si impregnim kundër depërtimit të ujit (trajtim hidrofob) për nënshtresa absorbuese si betoni në struktura të inxhinierisë së ndërtimit ose në ndërtimin e strukturave prej betoni.

- I përshtatshëm për mbrojtje kundër depërtimit (Parimi 1, metoda 1.1, EN 1504-9),
- I përshtatshëm për kontroll lagështie (Parimi 2, metoda 2.1, EN 1504-9)
- I përshtatshëm për rritje rezistence (Parimi 8, metoda 8.1, EN 1504-9)

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Reduktim i absorbueshmërisë kapilare të ujit.
- Redukton efloreshencën.
- Redukton depërtimin e pisllekut në pore.
- Përmirëson izolimin termik.
- Mund të vishet me veshje me bazë tretësi dhe dispersioni.
- Qëndrueshmëri dhe rezistencë më e lartë se trajtimet tradicionale me bazë silikoni.
- Zakonisht nuk e ndryshon paraqitjen e nënshtresës.
- Redukton hyrjen dhe lëvizjen e joneve të klorurit.
- Nuk vepron si pengesë avulli.

MIRATIME / STANDARDE

- Testuar nga LPM - testim kualifikimi bazuar në SIA 162/5, Raport A-13719-2 data prill 1993 - Absorbueshmëri uji, thellësi depërtimi, rezistencë ndaj alkaleve, përhapje e avujve të ujit.
- Përputhet me kërkesat e EN 1504-2 kategoria I - MPL, Sika Tüffenwies data shtator 2008
- Impregnim hidrofob sipas EN 1504-2 dhe mbart markën CE

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	përzjerje silani/siloksani në tretës organik
Ambalazhi	kovë 5 dhe 20 l
Paraqitja / Ngjyra	lëng pa ngjyrë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar.

Kushtet e magazinimit	Të ruhet në kushte të thata dhe të freskëta. Të mbrohet nga lagështia.
Dendësia	~ 0.800 kg/l (në +20°C)
Pika e ndezjes	Enë e mbyllur: ~30°C (~86°F)

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	1–2 x Sikagard®-700 S.
-----------------------------	------------------------

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	~ 0.300–0.500 kg/m ² (0.375–0.625 l/m ²) për veshje për nënshtresë me absorbueshmëri normale. Për të siguruar qëndrueshmëri, duhet të aplikohen min. 2 veshje.
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +30 °C max.
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +30 °C max.
Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	<5-6% kur matet me metodën Tramesx
Koha e pritjes / mbiveshja	Mund të mbivishet me bojëra polimere me bazë uji/tretësi - kontaktoni prodhuesin e bojës për detaje. Kur mbivishni me Sikagard® ose SikaColor® Emulsion apo veshje me bazë tretësi, prisni të paktën 5 orë pas impregnimit hidrofob.
Metoda e maturimit	Sikagard®-700 S nuk kërkon ndonjë trajtim të veçantë, por duhet të mbrohet nga shiu për të paktën 3 orë në +20°C.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Pa pluhur, vaj, efloreshencë dhe veshje boje ekzistuese.

Plasaritjet në beton më shumë se 200 µm duhet të riparohen përpara aplikimit të trajtimit hidrofob. Pastrimi arrihet më mirë duke fshirë me detergjentë të përshtatshëm ose me pastrim me fryrje, pastrim me avull etj.

Rezultate më të mira përfitohen tek nënshtresat shumë të thata dhe absorbuese. Nënshtresa duhet të ketë paraqitje të thatë pa pjesë të lagështa.

PËRZIERJA

Sikagard®-700 S është gati për përdorim dhe nuk duhet të hollohet.

APLIKIMI

Sikagard®-700 S aplikohet duke përdorur spërkatje në presion të ulët, furçë ose rul, duke punuar nga poshtë-lartë dhe duke u kujdesur që produkti mos rrjedhë. Aplikoni veshjet në vijim “të njomë mbi të njomë”.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me white spirit (tretës / diluent).

Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Mosha minimale e betonit ose llaçit: të paktën 4 javë.
- Nuk mund të mbivishet me ujë gëlqere ose bojë çimentoje.
- Nëse ka kërkesa estetike të rrepta (zakonisht kur përdoret mbi gur natyror), rekomandohet kryerja e testeve paraprake, pasi mbi disa gurë mund të rezultojë errësim i lehtë i sipërfaqes.
- Sikagard®-700 S nuk ka për qëllim hidroizolim nën presion hidrostatik, në kontakt të përhershëm me ujin, ose hidroizolim nëntokë.
- Sikagard®-700 S nuk ka për qëllim të mbylljen e plasaritjeve të dukshme nga hyrja e lagështisë.
- Pjesët e ndërtesës që nuk do të vishen (p.sh. korniza alumini, dritare etj.) duhet të mbrohen nga kontakti me Sikagard®-700 S. Në rast spërkatjesh, pastroni menjëherë duke përdorur një tretës shtesë nëse nevojitet.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikagard®-700 S

Mars 2019, Botimi 01.01

020303010010000001

Sikagard-700S-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf